



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 14.10.2015 në orën: 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Procesverbal

i mbledhjes së komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti, Sadri Ferati, Kujtim Paçaku, Xhevahire Izmaqi, Alma Lama.

Mungoi: Shqipe Pantina, Pal Lekaj, Jelena Bontiq dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit: zëvendësministri i MAP-së, z. Hajredin Hyseni dhe zyrtarët e MAP-së, OSB, KDI dhe BRN.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Zenun Pajaziti, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Zenun Pajaziti tha se si komision, pas miratimit në parim të P/ligjit, i kemi përcjellë vërejtjet teknike për P/ligjin me kërkesën që duhet një ekspertizë profesionale. Tani grupi punues ka pranuar ekspertizën e ekspertit të caktuar nga vetë komisioni, lidhur me këtë kërkoi miratimin nga anëtarët e komisionit.

Konstatim – komisioni unanimisht miratoi ekspertizën e ekspertit ligjor.

Ai pastaj, ia dha fjalën kryesuesit të grupit punues.

Sadri Ferati e njoftoi komisionin që grupi punues në këtë fazë pune ka marrë për bazë Ligjin e procedurës administrative të Shqipërisë për të krahasuar me tekstin e P/ligjit, pasi që edhe Ligji i

Shqipërisë ishte hartuar nga Sigma. Tani grupi punues në punëtorinë e cila do të mbahet në javën e ardhshme do të shqyrtojë të gjitha propozimet, vërejtjet që i janë adresuar komisionit lidhur me P/ligjin dhe do të hartojë propozim- amendamentet të cilat pastaj do t'i paraqet para komisionit.

Alma Lama duke shprehur paqartësitë se pse duhet që në punën e grupit punues për amendamentimin e P/ligjit duhet të marrë pjesë edhe Qeveria, pasi që ata kanë kryer punën e tyre, në mënyrën e tyre më të mirë të mundshme dhe mbi bazë të pavarësisë së dy institucioneve Qeveri, Kuvend dhe kompetencave që kanë, kjo do të konsiderohet si përzierje e punëve. Lidhur me këtë ajo kërkoi sqarime.

Zenun Pajaziti iu përgjigj se prezenca e përfaqësuesve të MAP-së është ndihmëse për komisionin për faktin se nga takimet e kaluara me ministrin e MAP-së ai ka reflektuar që do t'i ndihmojë komisionit duke përfshirë edhe SIGMA-në, e cila ka hartuar P/ligjin me qëllimin më të mirë që së bashku t'i evitojnë mangësitë e tekstit të P/ ligjit.

Hajredin Hyseni - zv.ministër tha se është në interes të Ministrisë të përcjellim punën e komisionit për sqarime apo edhe paqartësi për ndonjë nen, sipas kërkesës së komisionit, sepse ministria është ajo që do ta zbatojë ligjin pas miratimit nga Kuvendi.

Sadri Ferati kërkoi nga përfaqësuesit e MAP-së t'i hartojnë propozimet për përkufizimet, në P/ligj.

Konstatim – Komisioni vendosi mbajtjen e një punëtorie dyditore për shqyrtimin e propozimeve vërejtjeve dhe hartimin e propozim amendamenteve për P/ligjin.

3. Të ndryshme.

Zenun Pajaziti e njoftoi komisionin se Ligjin për RTK-në, i cili veç është në fazën e plotësim ndryshimit. Ne, si komision, duhet ta përfundojmë deri në fund të vitit kalendarik, përkatësisht para miratimit të buxhetit vjetor, për arsye të mos mbështetjes financiare sipas dispozitave të Ligjit në fuqi për RTK-në.

Xhevahire Izmaku propozoi që të caktohet vizitë në Agjencinë e Statistikave, pasi që kjo vizitë nuk u realizua më herët sipas agjendës së komisionit, në mungesë të kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave.

Sadri Ferati propozoi që raporti me rekomandime për monitorimin e Ligjit për kufijtë administrativ të komunave të shtyhet për kohë të pacaktuar.

Komisioni caktoi mbledhjen e radhës më 16 tetor 2015, e premte, me rendin e ditës: Plotësim-ndryshimi i Ligjit për RTK-në.

Mbledhja përfundoi në orën: 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Zenun Pajaziti